

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7958
E shtunë, 21 dhjetor 2024
Çmimi 0.50

Çfarë po ndodh me aktakuzën e dytë ndaj Thaçit? FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS DHE AI I SHQIPËRISË KANË MBAJTUR SEANCËN E PËRBASHKËT PARLAMENTARE FAQE 4-5

RAMA E THOTË TROÇ: E SOTMJA NUK DO TË ISHTE E NJËJTË PA HASHIM THAÇIN

OPINION

LV-ja 499 999 VOTA
MUND T'I FITOJË,
500 000 ASNJËHERË F.5

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



ALI AHMETI: KANË KËRKUAR TË MË VRASIN POLITIKISHT F.6

'EDHE NJË PREMTIM I MBAJTUR',
HAMZA PËRURON 'BALLKONIN
PANORAMIK' DHE SHTEGUN E ECJES
NË ZASELLË F.6

RRITEN RASTET E GRIPIT NË
KOSOVË, IKSHPK-JA KËRKON NGA
QYTETARËT TË VAKSINOHEN F.6

EKONOMI



ABDIXHIKU TAKON 150 BIZNESET MË
TË MËDHA NË KOSOVË: JU KONSIDEROJ
PARTNERË DHE PATRIOTË F.8

PËRURUHET RRUGA NACIONALE
N2 PRISHTINË - MITROVICË, KURTI:
KJO RRUGË E KA MOSHËN GATI TË
SHPALLJES SË PAVARËSISË F.8

- Thaçi, Veseli,
Krasniqi dhe
Selimi po mbahen
peng prej gati 5
vjetësh në qelitë
e një drejtësie
ndërkombëtare e
cila ka zhgënjyer
këdo



Kuvendi i Kosovës dhe ai i Shqipërisë kanë mbajtur të premtën një seancë të përbashkët parlamentare në Prishtinë. Në këtë seancë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka mbajtur një fjalim përmbajtësor në lidhje me

procesin gjyqësor në Hagë ndaj liderëve të UÇK-së. Ai ka thënë se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi po mbahen peng prej gati pesë vjetësh në qelitë e një drejtësie ndërkombëtare e cila ka zhgënjyer këdo. Në këtë kontekst,

Rama është treguar i ashpër kur ka theksuar se Kuvendi i Kosovës nuk ka bërë asgjë për të nxjerrë një rezolutë për padrejtësinë në Gjykatën Speciale. Rama ua ka kujtuar të gjithëve se e sotmja nuk do të ishte e njëjtë pa Hashim Thaçin

BE-ja, MISION
VËZHGUES PËR
ZGJEDHJET
E 9 SHKURTIT
NË KOSOVË F.8



PROKURORIA
SPECIALE I ÇON
FTESË PËRSËRI,
KURTI KËRKON TË
INTERVISTOHET NË
ZYRËN E TIJ F.3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Dëmtohen ambasada e Shqipërisë dhe e Maqedonisë së Veriut nga sulmet ruse në Kiev

KIEV, 20 DHJETOR - Sulmet me raketa që goditën kryeqytetin ukrainas, Kiev, mëngjesin e së premtes, kanë dëmtuar edhe ndërtesat ku ndodhen ambasada e Shqipërisë dhe e Maqedonisë së Veriut. "Si pasojë e këtyre sulmeve u dëmtuan pjesërisht fasada e jashtme dhe disa hapësira brenda godinës së Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Kiev dhe ambasadave të pesë vendeve të tjera, duke vënë në rrezik jetën e personelit diplomatik. Raportohet vetëm për dëme materiale", është thënë në një njoftim të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë.

Duke dënuar sulmin, ministria ka thënë se sulmi është akt i pakuptimtë ndaj themeleve të diplomacisë ndërkombëtare. Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Tregtisë së Jashtme e Maqedonisë së Veriut ka thënë se personeli diplomatik i pranishëm në ambasadë nuk është lënduar. Në reagimin e saj, ministria ka dënuar ashpër sulmet me raketa të kryera nga

ushtria ruse. "Shërbimet kompetente kanë kryer kontrollin fillestar të dëmtimeve në vend dhe tashmë po punohet për riparimin e tyre", ka njoftuar të premten nga ministria.

Sipas raportimeve, mësohet se në shënjestër ka qenë një ndërtesë pranë ambasadës maqedonase, e përdorur nga shërbimet e sigurisë ushtarake të Ukrainës.

Ndërkohë, autoritetet lokale në Ukrainë kanë njoftuar se të paktën dy persona kanë humbur jetën dhe disa të tjerë janë plagosur gjatë valës intensive nga bombardimet ruse që goditën Kievin bashkë me rajonin jugor të Heronit.

Në të gjithë Ukrainën janë lëshuar sirena për të paralajmëruar sulme ajrore për disa orë. Sipas kreut të administratës ushtarake të Kievit, Serhiy Popko, Rusia ka hedhur tetë raketa, përfshirë raketa hipersonike Kinzhal dhe raketa balistike Iskander/KN-23, vetëm në Kiev.

Bombardimet e së premtes në Ukrainë pasuan deklaratën e



presidentit rus, Vladimir Putin, i cili të enjten propozoi "një duel të armëve të shekullit 21", mes Shteteve të Bashkuara dhe Rosisë, për të treguar fuqinë e raketës së re hipersonike balistike të Rosisë, e quajtur Oreshnik, për të cilën tha se nuk mund të shkatërrohet nga

mbrojtjet ajrore të Perëndimit. Zyrtarët perëndimorë i kanë hedhur poshtë këto pretendime. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt të vitit 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin e ka quajtur luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar

Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rosisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

ShBA-ja dhe Britania sanksionojnë zyrtarët e Ministrisë së Brendshme të Gjeorgjisë

WASHINGTON/LONDËR, 20 DHJETOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Mbretëria e Bashkuar kanë vendosur sanksione ndaj ministrit të Brendshëm të Gjeorgjisë, Vaxhtang Gomelauri, dhe zyrtarëve të tjerë të lartë në ministri, si përgjigje ndaj rolit të tyre të dyshuar në shtypjen e dhunshme të gazetarëve, figurave opozitare dhe protestuesve antiqeveritarë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë vendosur sanksione ndaj Mirza Kezevadze, zëvendëshefit të Departamentit të Forcave Speciale në Ministrinë e Brendshme të Gjeorgjisë, ka njoftuar Departamenti Amerikan i Thesarit. Departamenti i Thesarit ka deklaruar se këto veprime janë



ndërmarrë në bashkëpunim me Britaninë, e cila më 19 dhjetor ka vendosur sanksione ndaj Gomelaurit dhe katër zyrtarëve të tjerë të Ministrisë së Brendshme për shkelje të dyshuara të të drejtave të njeriut. Një zyrtar i Departamentit Amerikan të Thesarit ka thënë se arsyt e cituara nga të dyja qeveritë për vendosjen e sanksioneve janë të ngjashme. "Pas zgjedhjeve në Gjeorgji, zyrtarë kyç në Ministrinë e

Punëve të Brendshme u përfshinë në shtypjen e popullit të vet në mënyrë të egër, duke përfshirë shënjestrimin e qëllimshëm të gazetarëve dhe përdorimin e dhunës", ka thënë Bradley T. Smith, nënsekretar i përkohshëm i Thesarit për Terrorizëm dhe Intelgjencë Financiare.

Çdo aset i zotëruar nga Gomelauri dhe Kezevadze në juridiksionin amerikan është bllokuar, ka thënë Departamenti i Thesarit.

Përveç Gomelaurit, Britania ka vendosur sanksione edhe ndaj zëvendësministrit të Brendshëm Aleksandre Darakhvelidze, Sulkhan Tamazashvili, Zviad Kharazishvili dhe Mileri Lagazauri, sipas një komunikate të Qeverisë britanike.

Mijëra njerëz kanë demonstruar përsëri në Tbilisi në natën e 19 dhjetorit. Kjo ishte dita e 22-të radhazi e protestave kundër vendimit të qeverisë për t'i ndërprerë praktikisht bisedimet për anëtarësimin e vendit në BE. Protestuesit e kanë vënë në pikëpyetje legjitimitetin e fitores së partisë Ëndrra Gjeorgjiane në zgjedhjet që u mbajtën në fund të tetorit.

Protestat janë rritur pasi kryeministri gjeorgjian Irakli Kobakhidze ka njoftuar se Tbilisi i ka pezulluar deri në vitin 2028 bisedimet me Brukselin për anëtarësimin e Gjeorgjisë në Bashkimin Evropian.

Presidentja proeuropiane e Gjeorgjisë, Salome Zurabishvili, ka thënë se zgjedhjet e 26 tetorit janë manipuluar me ndihmën e

Moskës dhe është zotuar se nuk do të largohet nga detyra edhe kur pasardhësi i saj - i përzgjedhur nga ai që protestuesit e quajnë Parlament të paligjshëm - të betohet më 29 dhjetor. Zurabishvili i ka dënuar "sulmet brutale ndaj popullit dhe medieve gjeorgjiane", duke e krahasuar shtypjen e tyre nga autoritetet me "represionin në stilin rus". Protestat janë shpërndarë vazhdimisht në mënyrë të dhunshme, aktivistët janë arrestuar dhe politikanët e opozitës dhe përfaqësuesit e medias janë sulmuar.

Gjeorgjia e mori statusin e vendit kandidatit për BE në dhjetor 2023 dhe, sipas sondazheve, shumica e gjeorgjianeve e mbështesin anëtarësimin e vendit në BE.

Mbyten tetë imigrantë në një ishull grek

Athinë, 20 dhjetor - Tetë emigrantë janë mbytur të premten në mëngjes pranë ishullit Rodos në Greqi, pasi anija e shpejtë me të cilën po lundronin u përmbys, kanë thënë autoritetet greke.

Roja bregdetare ka thënë se incidenti ndodhi pasi anija e shpejtë bëri "lëvizje të rrezikshme" në përpjekje për t'i

ikur një anijeje patrulluese, duke i hedhur imigrantët në ujë. Autoritetet greke thanë se 18 emigrantë të tjerë u shpëtuan dhe se kërkimet për shpëtimin e imigrantëve të tjerë janë duke vazhduar. Nuk është e qartë se sa imigrantë po barte anija kur është përmbysur, sipas tyre. Rodosi, një nga disa ishujt e mëdhenj

greqë, që shtrihet pranë bregdetit të Turqisë, është rrugë e dendur për trafikim të imigrantëve në lindje të Detit Mesdhe.

Ky është incidenti i dytë vdekjeprurës me imigrantë në këtë ishull këtë javë.

Shtatë emigrantë humbën jetën dhe dhjetëra të tjerë besohet se janë zhdukur kur

anija e tyre u fundos pjesërisht në jug të ishullit të Kretës gjatë fundjavës së kaluar.

Numri i imigrantëve që shkojnë në Greqi jashtëligjshëm pritet të rritet në 60 000 këtë vit. Sirianët përbëjnë numrin më të madh të tyre, të ndjekur nga afganët, egjiptianët, eritrianët dhe palestinezët, sipas të dhënave qeveritare.



Çfarë po ndodh me aktakuzën e dytë ndaj Thaçit?

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Teksa rasti i parë gjyqësor kundër ish-udhëheqësit të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, nën akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, po shkon drejt përfundimit në Hagë, Gjykata Speciale ka ngritur aktakuzën e dytë kundër tij – këtë herë për pengim të drejtësisë, duke kthyer gjithë vëmendjen mbi të dhe mbi deklaratimet e tij.

Thaçi, ish-president i Kosovës, ka përsëritur, të paktën dy herë në javët e fundit, domosdoshmërinë e respektimit të Kushtetutës dhe të ligjeve të Kosovës nga Specialja, teksa ka përmendur se dy aktakuzat kundër tij janë ngritur vetëm pak muaj para mbajtjes së zgjedhjeve në Kosovë. “Unë nuk jam pjesë e garës politike dhe as nuk kam ndonjë ambicie politike, as për president, as për kryeministër, as për deputet, e as ndonjë ambicie tjetër për ndonjë pozitë publike. E theksoj që nuk jam pengesë dhe as nuk paraqes rrezik për askënd, në kuptimin politik, e as për ndonjë projekt qeverisës”, ka thënë Thaçi në gjyq.

Për përmendjen e Kushtetutës nga Thaçi, njohës të drejtësisë

kanë pak për të komentuar. Duke mos pasur qasje në aktakuzën e plotë ndaj tij, dhe duke mos dashur të futen në spekulime, ata presin që vetë Thaçi, ose avokati i tij mbrojtës, të japin më shumë hollësi kur të deklarohen rreth fajësisë për aktakuzën e dytë. Avokati i Thaçit, Lluca Misetiq, nuk u është përgjigjur pyetjeve të “Radios Evropa e Lirë” për t’i sqaruar deklaratat e klientit të tij.

Drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se “në bazë të Kushtetutës, në bazë të Kodit të Procedurës Penale, janë disa të drejta të pandehurit në procedurë, për të cilat ai po mendon që nuk po i respektohen”. “Nëse aktakuza nuk është e bazuar në ligj, atëherë padyshim që është shkelje e Kushtetutës, sepse Kushtetuta e mbron barazinë e palëve në procedurë, i ka disa garanci për të pandehurit, që aktakuzë mund të ngrihet vetëm kur ka bazë ligjore, kur ka dëshmi, kur ka argumente”, ka thënë ai.

Thaçi duhet të deklarohet rreth fajësisë në afat prej 30 ditësh. Aktakuza e dytë kundër tij u miratua më 29 nëntor, ndërsa u



bë publike më 7 dhjetor. Miftaraj ka përsëritur thirrjet e vazhdueshme të IKD-së që gjyqtarët dhe prokurorët e Gjykatës Speciale ta ruajnë integritetin e procesit gjyqësor – të sigurojnë që dëshmitarët të mos kërcënohen, si dhe të ketë pasojë për ata që e bëjnë kërcënimin. “Thuhet se që prej vitit 2023-2024, këta persona (Thaçi dhe të tjerë) kanë marrë pjesë në frikësim të dëshmitarëve, dhe arrestimet ndodhin në fund të vitit 2024. Në aspektin penal është e pakuptueshme se si, pavarësisht që kanë pasur informata që një vit, nuk kanë marrë veprime, por po marrin në fund”, ka thënë ai.

Miftaraj e ka konsideruar shumë të rëndësishme që të ketë epilog procesi gjyqësor kryesor, dhe që të mos marrë vëmendje procedura e dytë. “Pothuajse në fund të marrjes në pyetje të dëshmitarëve, kur kanë mbetur edhe dy-tre muaj, të nisësh aktakuzë të re, në aspektin juridik, në aspektin logjik, nuk ka shumë kuptim”, ka thënë ai.

Lidhja e aktakuzave me zgjedhjet

Deklaratën e Thaçit, ku ai bën një lidhje mes aktakuzave dhe zgjedhjeve në Kosovë, Miftaraj e sheh politike dhe shumë të

përgjithshme. Ndërkaq hulumtuesi ligjor në Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Amer Alija, beson se ato as që do të merren parasysh nga trupi gjyqësor. “Këto deklarata fare nuk kanë rëndësi për procedurat ligjore, pasi që zgjedhjet në Kosovë nuk i hyjnë në punë as mbrojtjes, dhe as gjykatës, apo trupit gjyqësor në procedurat në të cilat ai ngarkohet”. Thaçi, ish-drejtuës i Partisë Demokratike të Kosovës, është në paraburgim në Holandë prej nëntorit të vitit 2020.

Puna e Gjykatës Speciale

Gjykata Speciale është themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar në Hagë. Kjo gjykatë heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të UÇK-së, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë, nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Puna e gjykatës financohet nga Bashkimi Evropian dhe nga disa vende të tjera perëndimore. Nga buxheti i Kosovës paguhen avokatët, si dhe udhëtimet e dëshmitarëve dhe vizitat e familjarëve të të akuzuarve.

Çështja e dëmshtëpërblimit të viktimave nuk është e rregulluar mirë me ligjet, mbi të cilat është formuar gjykata.

Si Miftaraj, ashtu edhe Alija, kanë vlerësuar se në bazë të asaj që ka qenë e qasshme për publikun, gjykata po bën punë të mirë dhe është e paanshme. Megjithatë, Miftaraj ka thënë se “së paku një prej gjyqtarëve shihet që po del prej rolit të tij si gjyqtar. Kemi parë shumë herë pyetje orientuese, pyetje sugjestive, ose në njëfarë mënyre duke bërë përpjekje që të marrë një përgjigje që atij i pëlqen ndaj dëshmitarëve”, teksa nuk ka pranuar ta identifikojë atë.

Njohësit e drejtësisë nuk shohin asnjë problem as rreth takimeve që është raportuar të jenë zhvilluar në mes të zyrtarëve të gjykatës me disa përfaqësues të vendeve sponsorizuese, duke thënë se ato janë vende mike të Kosovës, dhe se nuk besojnë që në ato takime të jetë diskutuar për ndonjë rast apo provë, por për mbarëvajtjen e përgjithshme të punës së këtij institucioni. Gjykata Speciale deri më tani ka shpallur dy aktgjykime për krime lufte, ndaj Salih Mustafës dhe Pjetër Shalës, dhe dy të tjera për pengim të administrimit të drejtësisë, ndaj Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucatit.



Prokuroria Speciale i çon ftesë përsëri, Kurti kërkon të intervistohet në zyrën e tij

Prishtinë, 20 dhjetor - Prokuroria Speciale ka përcjellë një ftesë të dytë në adresë të kryeministrit Kurti për intervistim në cilësinë e dëshmitarit, ka bërë me dije zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu.

Kryeziu ka thënë për “RTK”-në se kabineti i kryeministrit i është përgjigjur kësaj ftese duke ritheksuar gatishmërinë e kryeministrit që t’i mirëpresë

prokurorët në zyrën e tij për intervistim. “Për këtë kemi propozuar tre orare të takimit. Një për sot, dhe dy orare të tjera për javën tjetër. Presim një përgjigje pozitive meqë, sipas praktikës, kjo nuk do të ishte hera e parë që një kryeministër intervistohet brenda zyrës së tij, dhe i mirëpresim në kryeministri”, ka thënë Kryeziu. Kryeministri Kurti ishte ftuar të hënën nga Prokuroria Speciale

për t’u intervistuar si dëshmitarë, por nuk ishte paraqitur, pasi që ndodhej për vizitë zyrtare jashtë vendit. Zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu, edhe të hënën ka thënë se kryeministri Kurti ka shprehur gatishmërinë t’i mirëpresë prokurorët e rastit në zyrën e tij në një ditë dhe orë të dakorduar nga të dy palët për ta përmbushur kërkesën e dalë nga ftesa e prokurorisë.





KUVENDI I KOSOVËS DHE AI I SHQIPËRISË KANË MBAJTUR SEANCËN E PËRBASHKËT PARLAMENTARE

Rama e thotë troç: E sotmja nuk do të ishte e njëjtë pa Hashim Thaçin

- Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi po mbahen peng prej gati 5 vjetësh në qelitë e një drejtësie ndërkombëtare e cila ka zhgënjyer këdo

Kuvendi i Kosovës dhe ai i Shqipërisë kanë mbajtur të premtën një seancë të përbashkët parlamentare në Prishtinë. Në këtë seancë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka mbajtur një fjalim përmbajtësor në lidhje me procesin gjyqësor në Hagë ndaj liderëve të UÇK-së. Ai ka thënë se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi po mbahen peng prej gati pesë vjetësh në qelitë e një drejtësie ndërkombëtare e cila ka zhgënjyer këdo. Në këtë kontekst, Rama është treguar i ashpër kur ka theksuar se Kuvendi i Kosovës nuk ka bërë asgjë për të nxjerrë një rezolutë për padrejtësinë në Gjykatën Speciale. Rama ua ka kujtuar të gjithëve se e sotmja nuk do të ishte e njëjtë pa Hashim Thaçin

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës dhe ai i Shqipërisë kanë mbajtur të premtën një seancë të përbashkët parlamentare në Prishtinë, në të cilën janë zotuar, përmes një deklarate, se do ta ndihmojnë njëra-tjetrën në arenën ndërkombëtare dhe do ta thellojnë bashkëpunimin mes vete.

Gjatë seancës, e cila ka zgjatur tri orë, liderët e të dyja vendeve kanë mbajtur fjalime para deputetëve të pranishëm nga të dyja vende, ku kanë ofruar mbështetjen e ndërsjellë dhe kanë lartësuar lidhjet historike në mes të dy vendeve. Deklarata e tyre e përbashkët, e cila është lexuar nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka theksuar se qëllimi i mbledhjes ishte që Kosova dhe Shqipëria ta bashkërendonin "agjendën

kombëtare" për arritjen e synimeve të përbashkëta strategjike.

"Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkim Evropian brenda kësaj dekade, integrimi euroatlantik i Kosovës, pra në NATO dhe BE, dhe njohjet përfundimtare të Kosovës si realitet i pakthyeshëm gjeopolitik, mbrojtja e të drejtave të shqiptarëve", është thënë në deklaratë.

Sipas kësaj deklarate, është

shprehur shqetësimi se pse BE-ja nuk e ka marrë parasysh ende kandidaturën e Kosovës për anëtarësim në BE, si dhe u ka bërë thirrje pesë vendeve të BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën, ta bëjnë këtë.

Deklarata, gjithashtu, ka dënuar sulmet e 24 shtatorit 2023 në Banjskë në veri të Kosovës, dhe shpërthimin në kanal in e ujit të "Ibër-Lepencit" në veri. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj deklarate i është bërë thirrje Serbisë ta ekstradojë në Kosovë Millan Radoičiqin, i cili ka marrë përgjegjësinë për sulmin në Banjskë ku kishte mbetur i vrarë një rreshter policor.

"Seanca e përbashkët dëshmon unitetin Kosovë - Shqipëri"

Në seancën e dy kuvendeve shqiptare, i pari që ka marrë

fjalën ka qenë kryeparlamentari Glauk Konjufca. Ai ka thënë se kjo seancë dëshmon unitetin e Kosovës dhe Shqipërisë përballë sfidave strategjike e gjeopolitike të sigurisë. "Edhe dy muaj bëhen tri vjet që nga agresioni i paprovokuar i federatës ruse. Si rajon dhe si Kosovë i kemi ndierë ndikimet e tërthorta e të drejtpërdrejta të këtij agresioni. Republika e Kosovës po e mbyll këtë vit e sulmuar nga elementët të cilët lidhen me Serbinë e që po e synojnë destabilizimin e Kosovës me metoda terroriste si dhe të luftës hibride. Sulmi që u bë para pak ditësh në kanal in e Ibër Lepencit nuk mund të konsiderohet ndryshe përveç si sulm terrorist nga ata që refuzojnë ta pranojnë Kosovën si një realitet sovran dhe si një rens ligjor dhe demokratik i cili nuk ka alternativë në tërë territorin e saj", ka thënë Konjufca.

Ai ka theksuar se organizator dhe mbështetës i këtij sulmi është Radojçiqi, i mbështetur drejtpërdrejt nga Vuçiqi “Mos të harrojmë që ky sulm ndaj infrastrukturës sonë kritike, furnizimit me ujë e energji, vjen një vit pas sulmit tjetër të rëndë që përjetoi republika jonë e që ishte sulmi në Banjskë. Organizator dhe mbështetës i këtij sulmi është Radojçiqi, i mbështetur drejtpërdrejt nga Vuçiqi, i cili ende mbetet i pandëshkuar nga drejtësia në Serbi e që pothuajse nuk ekziston fare”, ka deklaruar Konjufca.

Ndërsa kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Elisa Spiropali, ka thënë se bota duhet të kuptojë që Shqipëria dhe Kosova janë bashkë. “Ne që po takohemi jemi pak, duhet të takohemi të gjithë, aq sa jemi, aq sa shqiptarë ka bota, me miliona. Nuk prishin punë, përkundrazi. Nuk prish punë se s’na zë kjo sallë. Ka salla ku mund të çmallemi e të takohemi. Gjakovari ta takojë labin, mitrovicasi vlonjatin, derisa të dridhet toka në këmbët tona, derisa Adem Jashari të lëvizë në varr, derisa bota të kuptojë çfarë mund të bëjmë kur jemi bashkë. Halli është se me arrit deri te super-takimi e hipër-bashkimi duket herët. Kur nuk ke pulën, duhet me ngrënë shpend tjetër, edhe ky shpend qenka fort i shijshëm. Orientimit tonë të qartë në rrjedhat e reja i përgjigjet ky takim i sotëm, që dikton energji të reja. Përfarimin dhe modernizimin e shoqërive tona. Marrëveshja mes dy

kuvendeve u ka dhënë shtytje bashkëpunimit mes qeverive e afrimit të njerëzve tanë. Bashkëpunimi mes dy republikave shqiptare është strategjik. Kosova është prioritet kombëtar i Shqipërisë, Shqipëria është prioritet kombëtar i Kosovës. Shqipëria ka mbërritur në dyert e BE-së pas një rrugëtimi sflitës, si vend kandidat me shpejtësinë më të madhe integruese. Shqipëria e ka merituar më tepër se çdo vend tjetër anëtarësimin në BE”, ka thënë Spiropali, duke shtuar se herët ose vonë, Kosova do të jetë pjesë e institucioneve ndërkombëtare. “Herët a vonë është e qartë se Kosova do të jetë edhe një flamur më shumë në selinë e OKB-së, dhe një yll më shumë në flamurin evropian. Shqipëria ka mbështetur dhe do të vijojë ta mbështesë Kosovën në Këshillin e Evropës. Besojmë se pranimit si anëtar i 47 është vetëm çështje kohe e do të ndodhë shpejt”, ka thënë ajo.

Pas Spiropalit fjalën e ka marrë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, duke kërkuar bashkëpunim më të thellë në mes të dy shteteve shqiptare. “Kjo seancë e përbashkët parlamentare duhet të shërbejë si një thirrje për veprim. Një kujtesë se qëllimi ynë i përbashkët kërkon ambicie edhe më të madhe dhe përpjekje më të palodhshme. Ne po jetojmë në një kohë të trazuar, e cila tregon bashkëpunim dhe qëllim. Për Kosovën dhe Shqipërinë kjo nuk është një zgjedhje, por një domosdoshmëri. Një Shqipëri



më e fortë do të thotë një Kosovë edhe më e fortë. Një Kosovë më e suksesshme e ngrë edhe më lart Shqipërinë. Historia nuk do të na gjykojë me dashamirësi nëse nuk arrijmë ta shfrytëzojmë këtë moment për ta ndërtuar harmoninë e domosdoshmë”, ka thënë Osmani.

Ajo ka komentuar edhe zhvillimet në Maqedoni të Veriut. Sipas saj, ka tendenca që të shkunden themelet mbi të cilat është ndërtuar ky shtet. “Derisa po flasim dhe jemi bashkuar në këtë vend ende ekzistojnë tendencat për t’i shkundur themelet mbi të cilat

është ndërtuar Maqedonia e Veriut, pra për ta destabilizuar edhe këtë vend, duke larguar edhe të drejtat tashmë të fituara të shqiptarëve”, ka thënë Osmani.

Kurse kryeministri Albin Kurti ka bërë me dije se Kosova si asnjëherë më parë e ka shtrirë sovranitetin në veri. Në adresimin e tij në mbledhjen e përbashkët të dy kuvendeve, ai ka thënë se tani Kosova ka integritet të plotë. Sipas tij, më pjesa veriore nuk mund të destabilizohet. “Si asnjëherë më parë kemi shtrirë sovranitetin në veri të Kosovës, kemi integritet territorial dhe sot që po flasim,

në Kosovë mund të ketë akte sporadike terroriste, por nuk ka më burime të brendshme që mund të na cenojnë sigurinë apo stabilitetin. Aktet terroriste të orkestruara e të financuara nga Serbi janë shprehje e pafuqisë së saj. Dikur nuk kanë bërë akte terroriste sepse e kishin krejt në kontroll, tash që e kanë humbur kontrollin, bëjnë akte terroriste, por ky është fundi i tyre”, ka thënë Kurti.

Në adresimin e tij ai ka folur edhe për bashkëpunimin që të dy vendet kanë pasur gjatë këtij mandati. Ai ka bërë thirrje që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen.



Rama: E sotmja nuk do të ishte e njëjtë pa Hashim Thaçin, ky Kuvend nuk bëri asgjë për padrejtësinë në Hagë

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka mbajtur fjalim zjarrtë në seancën e përbashkët të dy kuvendeve shqiptare. Pjesa kryesore e adresimit të tij kishte të bënte me ish-presidentin Hashim Thaçi dhe krerët e UÇK-së në Hagë, Kadri Veselin, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimin.

Rama në mes të duartrokitjeve të deputetëve ka thënë se e sotmja nuk do të ishte e njëjtë pa Hashim Thaçin. "Pa përfaqësuesit e UÇK-së nuk nisemi, as sot, as nesër, asnjëherë. Vetëm bashkë. Ku janë sot përfaqësuesit e UÇK-së? Pa Hashim Thaçin e shokët e tij që udhëtuan bashkë me Rugovën e Qosjen, ne nuk e dimë, çfarë rruge do të kishte marrë fati i Kosovës, por çfarë ne dimë me siguri është se ato qaste nuk do të kishin ardhur, dhe e sotmja do t'i ngjante të shkuarës, pa Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në krye me Hashim Thaçin", ka deklaruar Rama, duke vazhduar adresimin e tij. "Sot që ne jemi të gjithë këtu në Kuvendin ku u shpall pavarësia e Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi po mbahen peng prej gati pesë vjetësh në qelitë e një drejtësie ndërkombëtare e cila ka zhgënjyer këdo që ka pritur prej saj virtytet e një shteti të së drejtës. As nuk e kam diskutuar ndonjëherë, as sot, të drejtën e asaj Gjykate Speciale për ta bërë punën që ia ka ngarkuar edhe



vendimarrja e kësaj sale, ku vetë Hashimi ka ngritur dorën për ta formuar?", ka thënë Rama.

Më tutje, Rama është treguar i ashpër kur ka theksuar se Kuvendi i Kosovës nuk ka bërë asgjë për të nxjerrë një rezolutë për padrejtësinë e Gjykatës Speciale të Hagës. "Nuk vij dot këtu në Prishtinë, ta gëlltis, në mungesë të Hashimit, Kadriut, Jakupit, në mungesë të Rexhepit. Është nyja e mbledhur në fyt, nga një dyshim shumë i madh, dhe i arsyeshëm se ai proces, është proces i parregullt ligjor, dhe se normat dhe standardet e tij janë nën standardet e drejtësisë që e financojnë atë farë gjykate. Nuk rri dot pa jua thënë këtu çudinë time për faktin se në këtë sallë

nuk është ndërmarrë asnjëherë një nismë për të kërkuar një rezolutë të mbështetur nga të gjitha forcat politike, të gjitha vendet financuese, shqetësimin e madh mbi standardet e atij procesi, dhe për ta kërkuar ngritjen e një misioni verifikimi. Gjykata është e pavarur, por standardet nuk janë të varura nga gjyqtarët", ka deklaruar Rama, duke shtuar se nëse Kuvendi i Kosovës ndërmerr një veprim për të votuar një rezolutë, të njëjtën do ta bëjnë edhe në Shqipëri. "Nëse Kuvendi i Kosovës, kurdo qoftë, do ta ndërmerre nismën për t'iu drejtuar të gjithave shteteve sponsorizuese të Gjykatës Speciale dhe për ta marrë në to cenimin e standardevë demokratike në procesin ligjor

kundër Hashim Thaçit, Krasniqit, Veselit dhe Selimit, dhe nëse do të na kërkohej që një nismë e tillë të merrej edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, PS do të angazhohej pa ngurrim që të njëjtën rezolutë ta depozitonte në Kuvendin e Shqipërisë", është shprehur Rama.

Kryeministri shqiptar në fjalën e tij ka përmendur edhe dialogun Kosovë - Serbi.

Ai ka thënë se Kosova mund ta japë provën përballë BE-së dhe NATO-s, duke i përmbushur në mënyrë të njëanshme të gjitha obligimet e dialogut jo për shkak të Serbisë, por për hir të martirëve, fëmijëve dhe për hir të bashkimit me Shqipërinë në Evropë, me kryeqytet të përbashkët Brukselin. "Kosova mund t'ia japë familjes

evropiane dhe NATO-s, në një kohë shumë të shkurtër, provën e padiskutueshme të vullnetit dhe përkatësisë së vetë në gjirin e Evropës dhe NATO-s, duke i përmbushur unilateralisht të gjitha kushtet e normalizimit me Serbinë, jo për hir të Serbisë, por për hir të martirëve dhe fëmijëve të vet dhe për hir të bashkimit tonë kombëtar në familjen evropiane, me kryeqytet të përbashkët Brukselin", ka thënë Rama, duke shtuar se Kosova s'ka asnjë arsye të presë se çfarë po bën Serbia.

Rama ka theksuar se Kosova e ka gjuhëzuar Serbinë 25 vjet më parë dhe sot, 25 vjet pas, duhet ta lë shtetin serb në bisht. Kryeministri Rama ka thënë se ky qëndrim nuk është leksion, por një këshillë vëllazërore e bazuar në përvojën e Shqipërisë në rrugën e integritit.

Gjatë seancës së përbashkët, Rama ka pranuar një pikturë si dhuratë nga Rexhep Selimi, i cili gjendet në paraburgim në Hagë. "I prekur nga kjo dhuratë e bukur prej koleksionit të pikturave të luftëtarit të UÇK-së, Rexhep Selimi, i cili ma përcolli sot nga Haga përmes kryetarit të Kuvendit të Kosovës. Shumë faleminderit me mirënjohje i dashur mik, e mezi pres ta shoh të marrë fund kalvari, gjithnjë e më i pajustifikueshëm i mbajtjes së të katërve ju peng atje në Hagë", ka shkruar Rama në "Facebook".





Haradinaj godet Kurtin në mbledhjen e dy kuvendeve: Veprimet e tij janë në agjendë të Serbisë dhe Ruisë

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, as në mbledhjen e dy kuvendeve nuk ka kursyer kritikën për kryeministrin Albin Kurti. Haradinaj ka thënë se Kurti është në shërbim të Serbisë e Ruisë. "Hapat e pakoordinuar të qeverisë bënë që Serbia të shihet si viktimë. Kosova është në të njëjtin thes me Korenë e Veriut nga kryeministri Kurti dhe qeveria e tij. Kryeministri ynë ka shkuar deri aty sa Blinkenin e ka quajtur naiv. Në vendin tonë tenderët njëburimorë janë kthyer në gjakderdhje financiare. Në vendin tonë janë vjedhur mielli e vaji. Pasuli është shpallur sekret shtetëror. Kryeministri sapo mashtroi më herët për investime në mbrojtje. Çdo veprim i Kurtit është në agjendë të Serbisë e Ruisë. Bëri përpjekje në Shqipëri, por



ju nuk e lejuat", ka thënë Haradinaj. Më tutje, Haradinaj ka kërkuar mbështetjen e Shqipërisë për anëtarësimin e Kosovës në NATO. Një gjë të tillë e ka bërë edhe

nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Enver Hoxhaj. "Para 10 vitesh, nën udhëheqjen e kryeministrit Thaçi dhe kryeministrit Rama, është mbajtur mbledhja e parë e të dy

qeverive. Ajo ka qenë shpallje e një partneriteti strategjik. Pa Shqipërinë nuk do të kishte as liri dhe as pavarësi", ka thënë Hoxhaj, duke shtuar se Shqipëria nuk ka pasur vetëm një rol solidar, por një rol

vendimtar për Kosovën, duke lobuar për njohjen ndërkombëtare dhe për anëtarësimin e saj në organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Ai i ka ftuar qeveritë dhe kuvendet e të dy vendeve që të përqendrohen në qëllime strategjike, duke theksuar rëndësinë e anëtarësimin të Kosovës në NATO si një objektivi madhor.

Në këtë mbledhje të përbashkët të dy kuvendeve nga një fjalë rasti kanë mbajtur edhe deputeti i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Gazment Bardhi, shefi i deputetëve të LDK-së, Arben Gashi, shefja e deputetëve të Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila, shefi i deputetëve të komuniteteve, Enis Kervan dhe deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, Mesila Doda, Fatmir Mejdriu e Niko Peleshi.



Ali Ahmeti: Kanë kërkuar të më vrasin politikisht

TETOVË, 20 DHJETOR - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, në një takim me qytetarët në Tetovë, ka kujtuar disa çaste të rëndësishme.

Ahmeti ka thënë se një kohë të gjatë është bërë plan që ai të vritet politikisht. "Ka

filluar një fushatë, jo tani, por tani ka dalë në sipërfaqe, e orkestruar aq bukur me vite të tëra se e keqja e këtij vendi qenka BDI-ja dhe ai duhet varrosur dhe të vritet politikisht Ali Ahmeti. Janë mbledhur, janë ulur e kanë

bërë analiza dhe diskutime dhe janë çuditur se u kemi rënë në fije (ju kemi rënë gjurmë) dhe u shkoj në konak në Strumicë. Ore, hiqni dorë. Me politika arkaike shteti e stabiliteti nuk bëhet", ka thënë Ahmeti.



BE-ja, mision vëzhgues për zgjedhjet e 9 shkurtit në Kosovë

BRUKSEL, 20 DHJETOR - Bashkimi Evropian (BE) do ta dërgojë një mision për t'i vëzhguar zgjedhjet parlamentare në Kosovë më 9 shkurt të vitit 2025, me kërkesë të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, njoftoi blloku evropian të premtën.

"Duke iu përgjigjur ftesës nga ana e presidentes së Kosovës, përfaqësuesja e lartë Kaja Kallas ka vendosur ta dërgojë një mision vëzhgues (EOM) për t'i vëzhguar zgjedhjet parlamentare në caktuar për 9 shkurt 2025", është thënë në njoftim.

Nathalie Loiseau, deputete e Parlamentit Evropian, është emëruar shefe e misionit vëzhgues, është thënë në njoftim.

BE-ja ka theksuar se misioni i saj vëzhgues për zgjedhjet në Kosovë do ta dëshmojë mbështetjen e vendosur të BE-së për Kosovën në përpjekjet e



saj për ta forcuar më tej qeverisjen demokratike.

"Prania e këtij misioni në terren ka për qëllim të kontribuojë për

një proces zgjedhorë gjithëpërfshirës, të besueshëm

dhe transparent, i cili do t'u mundësojë votuesve në Kosovë që të shprehin qartë zgjedhjen e tyre", është thënë në njoftim. Bashkimi Evropian (BE) i ka vëzhguar të gjitha zgjedhjet në Kosovë që nga viti 2013. Këto do të jenë zgjedhjet e para të rregullta parlamentare që do të organizohen në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë më 2008.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë (KQZ) ka bërë me dije se 28 subjekte politike kanë aplikuar për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Në mesin e 28 subjekteve politike janë 20 parti politike, pesë koalicionet, dy iniciativa qytetare dhe një kandidat i pavarur. Në mesin e subjekteve janë parti shqiptare, të komunitetit serb, dhe komunitetet të tjera më të vogla në Kosovë. KQZ-ja duhet t'i konfirmojë listat më së voni deri më 25 dhjetor.

Rriten rastet e gripit në Kosovë, IKShPK-ja kërkon nga qytetarët të vaksinohen

Prishtinë, 20 dhjetor - Bazuar në të dhënat nga mbikëqyrja javore e gripit sezonal, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se është rritur numri i rasteve të raportuara të gripit krahasuar me javët paraprake. Megjithatë, IKShPK-ja ka theksuar se numri i rasteve është i nivelit të krahasueshëm me sezonin paraprak.

Që nga fillimi i sezonit të gripit, fillimi i muajit tetor e deri më tani, përmes laboratorit të mikrobiologjisë në IKShPK janë konfirmuar 52 raste të gripit, disa prej të cilave, për shkak të



ashpërsisë, janë shtrirë për mjekim në spital.

Me qëllim të parandalimit të rasteve të reja dhe komplikimeve të rënda shëndetësore që mund të vijnë nga gripi, IKShPK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve që të vaksinohen kundër gripit në njësitë e vaksinimit (QKMF/QMF) në komunën ku jetojnë. "Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit. IKShPK rikujton se Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKShPK-në, në fillim të sezonit të gripit 2024/2025, ka siguruar 85 000

doza të vaksinës sezonale. Nga 30 shtatori deri më 30 nëntor janë administruar 61 467 doza për grupet e rrezikuara; grupmoshat mbi 65 vjeç; personat me sëmundje kronike; profesionistët shëndetësor; gratë shtatzëne dhe fëmijët 0-5 vjeç. Vakcina rekomandohet edhe për grupe të tjera të popullatës, pa dallim moshe. Gjithashtu, qytetarëve u bëhet thirrje t'i zbatojnë edhe masat e tjera parandaluese kundër virusit të gripit sezonal dhe kontroll të infeksioneve të rrugëve të frymëmarrjes", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

'Edhe një premtim i mbajtur', Hamza përruron 'Ballkonin Panoramik' dhe shtegun e ecjes në Zasellë

MITROVICË, 20 DHJETOR - Kandidati i PDK-së për kryeministër dhe kryetari i Mitrovicës, Bedri Hamza, ka realizuar edhe një tjetër premtim.

Hamza ka përruruar "Ballkonin Panoramik" dhe shtegun e ecjes në Zasellë. "Edhe një premtim i mbajtur! Sot përruruar

'Ballkonin Panoramik' dhe shtegun e ecjes në Zasellë, një projekt që shfaq një tjetër anë të bukur të Mitrovicës dhe fshatrave përreth, duke na mundësuar të shijojmë këto bukuri. Ky projekt, i realizuar nga Komuna e Mitrovicës dhe MZHR, sjell një shteg ecjeje me gjatësi prej mbi 1

kilometër, i cili u mundëson vizitorëve të ngjiten deri në 670 metra lartësi mbidetare, në 'Ballkonin Panoramik'. Nga atje, pas një ecjeje frymëzuese, mund të shijoni pamjet e bukura të qytetit dhe rrethinës. #MaMirë për natyrën dhe shëndetin!", ka shkruar Hamza në "Facebook".



LV-ja 499 999 vota mund t'i fitojë, 500 000 asnjëherë



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Malli i vjetër për pazar të ri: Partia LV, përkatësisht Cezari i saj e bëri prezantimin e kandidatëve për deputetë për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025. Përpos një ikonografie krejtësisht propagandistike - pornografike (të cullakosur nga mungesa e rezultateve), pati aso mashtrime dhe devijime nga realiteti, të padenja edhe për Grofin Minhauzen, sinonim i rrenave dhe mashtrimeve. Listat ishin bërë publike më herët, LV-ja ofroi listën second hand prej të cilëve afërsisht 95 për qind ishin ricikluar nga zgjedhjet e fundit kur LV-ja, e prirë nga presidentja e tashme, Vojsa Osmani fitoi mbi 50 për qind të votave. Albin Kurti nuk ishte pjesë e listës, për shkakë ligjore. Tash, Kurti është në krye të listës në përpjekje të thyej rekordin paraprak prandaj i ka hyrë së thelli fantastikës shkencore duke kërkuar 500.000 vota. Arsyetimi nuk është të hyjë në librin e rekordeve të Ginisit, por të "lirohet" nga Lista Serbe dhe "opozita e stërvjetëruar" që edhe ia bënë shtetin dhe ia lanë karrigen e KM të cilën, me dëshirë kurrë nuk e liron. Nëse dikush bënë aq shumë përpjekje për të ardhur në pushtet duke shkelur mbi të gjallë dhe të vdekur atëherë nuk lë të zezë pa bërë për ta mbajtur pushtetin. Në këtë pozitë sot është KM Kurti mirëpo nuk besoj se do ia dalë te 500.000 vota. Mund të shkojë deri në 499.999 vota, nëse luajmë lojën e ko... e apo filxhanëve anatomikë. Mirëpo, në aspektin psikologjik mirë po e luan lojën mashtruese duke bërë përpjekje që perceptimin ta shndërrojë në fakt, dëshirën në nevojë,

rrenën ta paketojë si të vërtetë. Tamam metodë gebelsiane. Herën e parë kërkonte mbi 50 për qind të votave me arsyetim që tani i kërkon 500.000 vota, lirim por jo edhe çlirim nga Lista Serbe sikur edhe lirim nga "opozita e stërvjetëruar". Dhe, cili ishte rezultati?! E trashi miqësinë me Listën Serbe duke e përdorur sekseren Kusari për komunikime të rregullta kundër UÇK-së dhe Kosovës sikur që e kthjelli opozitën duke e mobilizuar në aktivitete në diasporë sikur edhe brenda Kosovës. Merreni p.sh. listën e propozuar për deputetë nga Cezari i LV-së dhe i gjeni së paku 10 veta që kanë kontribuar personalisht apo familjarisht për lirinë e Kosovës dhe shqiptarët. Nuk i gjeni edhe nëse jeni akrobat i improvizimit! Ndërsa, lehtësisht i gjeni 60-70 për qind që nëse personalisht nuk kanë punuar për Jugosllavinë dhe Serbinë, paraardhësit e tyre ishin në vijat e para të frontit kundër patriotëve shqiptarë. Ka kandidatë që kanë një trashëgimi kombëtare dhe patriotike, por që jo se nuk e kanë vazhduar zinxhirin e gjenetikës kombëtare dhe patriotike, por i kanë turpëruar paraardhësit, qoftë nëse janë gjallë apo që është edhe më keq varret e tyre dhe kujtimin për ta. Albin Kurti dhe LV -ja nuk e urrejnë Listën Serbe, ata i urrejnë udhëheqësit e luftës që e fituan luftën, e sollën lirinë, e krijuan shtetin dhe e sollën pavarësinë duke siguruar mbi 115 njohje dhe afirmim ndërkombëtar. Çka bëri LV-ja për këtë mandat, asnjë njohje, asnjë

anëtarësim, pamundësi anëtarësimin në Këshill të Evropës për një kohë të gjatë duke siguruar një të arritur të pakundërshtueshme - futjen e sanksioneve. Nuk iu pëlqen Trampi dhe Grenelli, por as Bajdeni dhe Blinken. Nuk iu pëlqen Edi Rama e Ali Ahmeti, por iu pëlqen Terr Abazoviqi dhe Arben Travari, me Besnik Kojqen. E spastruan LV-në nga patriotët shqiptarë për t'i zëvendësuar me patriotë jugosllavë. E keqpërdorin flamurin dhe himnin kombëtar për qëllime politike, elektorale dhe personale. Klithmat paranojake të Kurtit për eliminim të opozitës së "stërvjetëruar" në kohën kur Listën Serbe nuk mund ta eliminonjë sepse nuk e lejon Kushtetuta e as ndërkombëtarët, në fakt është një përpjekje patologjike ta vendosë diktaturën njëpartiake ku veten do ta shpallte diktator të përjetshëm, si Cezari apo Pol Poti. Dithirambet për Donika Shvarcin shpërfaqin çarjen e personalitetit të Kurtit ose është në të njëjtat valë mendore dhe "intelektuale" me Shvarcin ose është mashtrues ordiner. Kur për një injorante sikur që është Donika Shvarc i thotë ato fjalë, merreni me mend se si do ta përshkruaj ajkën politike dhe intelektuale të saj siç, pa asnjë dyshim dhe pa asnjë ndryshim janë Halili, Mefi, Dilmali, ekstazitë e Prizrenit, kërkuesja e dashurisë, dhunuesja e drejtësisë, donkishoti i Policisë dhe paramilitari i xhirollogarisë së shtetit. Krijuesi i Botës dhe Universit dhe njëkohësisht krijuesi i qenies më të kompletuar e që

nuk mund të riciklohet sot dhe asnjëherë, nuk ia jep njeriut të gjitha, diçka i lë mëngut. Ta jep pabesinë, poshtërsinë, pushtetin por ta merr guxim. Dhe është mirë që është kështu. Fjalimi fashist i Albin Kurtit para turmës në sallën "1 Tetori" ishte ftesë e hapur për eliminim, fillimisht politik e pastaj, po të kishin gogla e që nuk i kanë edhe fizik përmes instrumentalizimit të policisë, një grupi të komandant Pasulit dhe disa mercenarëve informativ. Opozita po tregohet e matur dhe e durueshme ndryshe që moti do të niste skenari i një lufte qytetare, jo midis vëllezërve siç gabimisht interpretohet. Peci i Albinit po i ndanë 100 mijëshet edhe për dardha turshi në përpjekje për të mbetur në pushtet, si mizë e kalit në të pasmet e padronit të vet. Edhe sa 100 mijëshet do të ndahen deri më 9 shkurt 2025 sepse gazda ia ka ndarë edhe 14 milionë euro shtesë që nënkupton se për partinë dhe puthadorët, Peci i Albinit i ndanë edhe 140 100 mijëshe. Sa i poshtër dhe sa i padinjitetshëm. E keni vërejtur se pas zgjedhjeve në Amerikë, askush nga LV-ja nuk e përmend Trampin dhe se së paku deri më sot askush nuk ka thënë se refuzon "të shtrihet pranë (në shtratin) të Grenellit. Besoj se pasi Trampi ta merr pushtetin, Grenelli do të jetë i rrethuar në shtratin, nga refuzuesit e djeshëm. Zgjidh e merr! Dalja në zgjedhje përcakton rezultatin përfundimtar. LV-së i përshtrahet dalja sa më e vogël sepse shembja do të jetë më e vogël. Në vitin 2021 kanë votuar 903.800 votues shqiptarë, pakicat dhe nga diaspora. LV-ja ka fituar afërsisht 438.000 vota duke e përgjysmuar LDK-në me kontributin "bujar" të renegates Osmani dhe injorantes Shvarc. Tash, Zeusi i LV-së kërkon 500.000 vota në kohën kur nuk pritet se do të votojnë as 700.000 votues që nënkupton se përveç LV-së, partnerit të saj "Lista Serbe" që i kanë vendet e garantuara, Kuvendi i ardhshëm i Kosovës do të jetë Kuvendi i vëllazërim - bashkimit sikur Boro dhe Ramizi, ZdraVVo Mimoza dhe Radoiqi dhe Vokri e Radoica. Prapë besoj se asnjë parti nuk e kalon 35-përqindëshin se në Kuvend përveç koalicionit të natyrshëm LV dhe LS, pjesë mbase qeverisëse do të jenë PDK -ja, LDK-ja, AAK - NISMA, LISTA PËR FAMILJEN dhe pakicat joserbe. Por, nëse votuesit përcaktohen për koalicionin LV dhe LS ia pafshin hairin. Kështu e ka demokracia e sidomos autokracia. Garant për këtë e keni Mimoza Kusarin dhe Millan Radoiqiqin.

Po presidentja ku është: Presidentja Vojsa Osmani nuk po lë gur pa lëvizur edhe për një mandat andaj, herë mundohet ta imitojë Kurtin, herë Shvarcin në maskenballin ku është e rryer për ndërrim të maskave. Nuk ka lënë njeri pa ia lëshuar kmer për të fituar pushtet, tash po e luan rolin proamerikan, kundër burokratëve të Evropës të cilët i "qorton" me gjuhën e Kurtit, Besnik rrencit dhe injorantes Shvarc. Me vizitat turistike në ShBA po përpriqet të lë përshtypjen se amerikanët nuk munden pa te dhe se Tramp nuk e merr pushtetin pa lejen e saj. Pasi e shpëtoi Ukrainën, tash po e konsolidon edhe Amerikën. Çfarë mashtruese! Çfarë manipulante, nuk lë gjë pa bërë edhe për një mandat. Kinse është hidhëruar me Kurtin kurse vazhdimisht ia mbanë zhagun Kurtit duke i kritikuar "kufomat politike ndërkombëtare", Rrahman Morinën e Katalonjës - Borrellin dhe Mef Bajcinën e Sllovakisë - Miroslav Llaçak, i pari mohues-tradhtar i popullit të Katalonisë, i dyti rrenc dhe mashtrues ordiner. Dikush po thotë se nëse Atifete Jahjaga ka përfunduar mandarin pa asnjë votë të fituar, pse atëherë Vojsa Osmani nuk e merr edhe një mandat me më shumë se 300.000 vota. Demek, për të parën paskan votuar amerikanët, që është e vërtetë kurse për të dytën po vdiskan amerikanët, që aspak nuk është e vërtetë. Atifetja dhe Vjosa Osmani, përveç se janë të së njëjtës gjini, nuk kanë asgjë të përbashkët, as në aspektin kombëtar, tradicional dhe përmbytjesor, janë dy pole të kundërta, Atifetja shumë pozitive dhe Vjosa shumë negative. Ma tregoni një rast kur Atifetja ka folur keq për dikënd, ka folur keq për UÇK-në, për udhëheqësit politikë dhe ushtarak të luftës çlirimtare dhe në të njëjtën kohë më tregoni një rast të vetëm kur Vjosa Osmani ka folur një fjalë të mirë për Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin, bashkë me Albin Kurtin që tani po e ekzekuton politikisht Vjosën!! Asgjë nuk mbetet për botën tjetër, në këtë botë paguhen llogaritë!

Tredhja e mizave: Sot në Kuvendin e Kosovës organizohet një takim për bashkim kombëtar. Do të merren vendime historike, pa asnjë dyshim! Më intereson se si do ta komentojnë këtë "non grata" Berisha, andej kufirit dhe analisti llaskuç i pushtetit "prof. dr." Ramçej, këndej kufirit!

Abdixhiku takon 150 bizneset më të mëdha në Kosovë: Ju konsideroj partnerë dhe patriotë

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kandidati për kryeministër nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, gjatë takimit me 150 bizneset më të mëdha në Kosovë, ka deklaruar se i konsideron ata partnerë dhe patriotë

modernë të zhvillimit të vendit. Gjatë takimit Abdixhiku ka thënë se, fatkeqësisht, sot, në tavolinën e zareve të pushtetit qëndron lufta ideologjike ndaj ndërmarrësve të vendit. "Ju konsideroj partnerë. Ju

konsideroj patriotë modernë të zhvillimit të vendit. Ju konsideroj forca e vetme me të cilin mund ta shtroj vizionin tim përpara! Ndiej dhe përgjegjësi t'ju takoj dhe t'ju shpalos planet tona", ka thënë Abdixhiku.



Përurohet rruga Nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë, Kurti: Kjo rrugë e ka moshën gati të shpalljes së pavarësisë

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, zëvendësministrat Hysen Durmishi dhe Jeton Raka, ka marrë pjesë në përuroren e segmentit Stanovc - Hyrje e Vushtrrisë, rruga Nacionale N2 Prishtinë - Mitrovicë.

Rruga Prishtinë - Mitrovicë ka nisur në vitin 2009, mirëpo është dashur të ndërrohet operatori ekonomik në mënyrë që të ecë puna.

Kontrata për segmentin Stanovc - Hyrje e Vushtrrisë është nënshkruar në fund të muajit shkurtit të këtij viti dhe për dhjetë muaj po përurohet rruga me gjatësi prej 5.5 kilometrash e cila kalon në vendbanimet Lumi i Madh, Dumnicë e Poshtme, Maxhunaj, Pestovë, Samadrexhë, Sfarraqak dhe Nedakovc, ka tre nënkalime, një nënkalim për këmbësorë dhe një urë. Ndërkaq, punimet po vazhdojnë në segmentin tjetër të rëndësishëm Vushtrri -

Gojbulë, i cili ka afër 4.2 kilometra gjatësi. Për përfundimin e tërësishëm të kësaj rruge qeveria ka nënshkruar marrëveshje për hua në vlerë 15 milionë euro për ndërtimin e segmentit Smrekovnicë - Mitrovicë me gjatësi 5 kilometra.

Rehabilitimi nga një rrugë me dy korsi në atë me katër korsi, me drenazhim me gypa të ujërave në tërë gjatësinë e saj, trotuare për këmbësorë në vendet ku ka vendbanime dhe biznese, përmirësim të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit si dhe rrjetit elektrik, do të ndikojë në komunikacion më të sigurt dhe të shpejtë, qarkullim dhe transport më të shpejtë të mallrave dhe shërbimeve për bizneset dhe fermerët, si dhe mundësi zhvillimi më të madhe të pjesës veriore të Kosovës, qyteteve të Vushtrrisë, Mitrovicës dhe më gjerë.

"Rruga Prishtinë - Mitrovicë po bëhet. Ka nisur në vitin 2009 që domethënë e ka pothuajse moshën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, mirëpo



është dashur të ndërrohet operatori ekonomik në mënyrë që të ecë puna. Unë e falënderoj ministrin Liburn Aliu, zëvendësministrin Hysen Durmishi dhe gjithë stafin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për punën që kanë bërë. Ky segment është nënshkruar në fund të shkurtit si kontratë dhe për dhjetë muaj po e përurojmë në një gjatësi afër 5

kilometra e gjysmë. Ka ngelur edhe një pjesë tjetër shumë e rëndësishme e cila është rreth 5 kilometra Smrekovnicë - Mitrovicë dhe e cila do të kushtojë rreth 15 milionë euro. Janë kryer me përpikëri, me drejtësi edhe shpronësimet edhe rregullimi i trotuareve, edhe drenazhet, edhe gypat e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Është dashur të rregullohet edhe rrjeti elektrik, prandaj edhe ka

pasur shumë këso punësh, të cilët nuk është se shihen sot, mirëpo ministria, punëtorët, operatorët ekonomikë i kanë kryer dhe tash ne e kemi vetëm këtë asfaltin e lëmuar, në të cilin ecim me shpejtësi të paparë më herët. Unë erdha me një aktivist të Vetëvendosjes, i cili është nga Oshlani, edhe më tha prej Oshlanit - Prishtinë për 35 minuta ka qenë e paimagjineshme", ka thënë kryeministri Kurti.

Fushë-Kosova bëhet me nënstacion të ri energjetik, përfitojnë 15 mijë banorë dhe biznese



FUSHË-KOSOVË, 20 DHJETOR - Në Fushë-Kosovë është inauguruar të premten nënstacioni i ri i KOSTT-it, që pritet ta përmirësojë furnizimin me energji elektrike për 15 000 banorë dhe biznese të kësaj komune. Ministrja e Ekonomisë (ME), Artane Rizvanolli, gjatë ceremonisë së inaugurimit, ka thënë se ky është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit

të furnizimit me energji në Kosovë. "Ky nënstacion pritet të ketë një ndikim të konsiderueshëm në përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike te qytetarët e komunës së Fushë-Kosovës, duke siguruar më shumë stabilitet për konsumatorët dhe duke ndihmuar në plotësimin e nevojave në rritje të rrjetit energjetik të vendit. Nënstacioni

në Fushë-Kosovë është ndërtuar me teknologji të tensionit të lartë, ajo me izolim me gaz (Gas Insulated Switchgear - GIS), e cila ofron siguri maksimale në operim dhe minimizon ndikimin në mjedis", ka thënë Rizvanolli. Ky projekt, sipas ME-së, ka blerën totale prej 6.44 milionë eurosh, dhe përfshin investime në linjat e transmetimit dhe shërbën për rritjen e kapaciteteve të rrjetit energjetik në Kosovë.

Kosova në 13 vjet humbet 12 për qind të popullsisë

Prishtinë, 20 dhjetor - Në vitin 2011 në Kosovë jetonin 1.8 milion njerëz, sikurse ka njoftuar Agjencia e Statistikave të Kosovës të enjten. Sipas këtyre të dhënave, shqiptarët përbëjnë 90 për qind të popullsisë, e serbët mbi tre për qind. Të dhënat lidhur me popullsinë serbe, sipas ASK-së, bazohen

në vlerësime, sepse shumë prej pjesëtarëve të minoritetit serb e kanë bojkotuar censusin. Kosova vuan prej emigracionit masiv prej nga njerëzit largohen drejt vendeve të tjera në kërkim të punës. Sipas vlerësimeve zyrtare, rreth 800 000 kosovarë jetojnë dhe

punojnë në vendet e BE-së, gati gjysma e tyre në Gjermani. Në përgjithësi, censusi në shumë vende të Ballkanit është një çështje delikate: rënia e natalitetit, emigracioni masiv dhe tensionet etnike e vështirësojnë hulumtimin e saktë të numrit të popullsisë.





**KUZHINA
QËNDRORE**



Të ushqyerit shëndetshëm përgjatë çdo faze jetësore

Mungesa e vitaminave apo mineraleve gjatë fëmijërisë mund të shkaktojë probleme afatgjata, si anemi për shkak të mungesës së hekurit, dobësim të eshtrave, dobësim të imunitetit apo rritje të vonshme

Ushqimi i shëndetshëm për fëmijët është një nga faktorët më të rëndësishëm për parandalimin e të gjitha formave të kequshqyerjes (përfshirë nënushqyerjen, mungesën e vitaminave apo mineraleve, mbipeshën, obezitetin dhe sëmundjet jo të komunikueshme). Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH), kequshqyerja është një nga rreziqet më të mëdha të shëndetit publik. Nënushqyerja mund të shkaktojë ngecje në rritjen e fëmijës, duke pasur kështu ndikim në aftësitë njohëse dhe fizike të fëmijës. Mungesa e vitaminave apo mineraleve gjatë fëmijërisë mund të shkaktojë probleme afatgjata, si anemia si pasojë e mungesës së hekurit, dobësim të eshtrave, dobësim të imunitetit apo rritje të vonshme. Ndërkaq, mbipeshja dhe obeziteti janë ndër faktorët kryesorë të zhvillimit të sëmundjeve jo të komunikueshme, si diabeti i tipit 2, sëmundjet e zembrës apo kanceri. Prandaj, të ushqyerit shëndetshëm në kopshte dhe shkolla ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin dhe shëndetin e fëmijëve.

Planifikimi i menisë ka për qëllim të ndihmojë në përmbushjen e rekomandimeve

për ushqyerjen e shëndetshme të fëmijët, të adaptuara nga Rekomandimet Dietetike Amerikane 2020-2025. Rekomandimet bazë janë:

1. Të ndiqet një model i të ushqyerit shëndetshëm përgjatë çdo faze jetësore.

a) Deri në 6 muajt e parë të jetës, foshnjat duhet të ushqehen ekskluzivisht me qumësht gjiri ose formulë të pasuruar me hekur. Foshnjave duhet t'u jepet suplement i vitaminës D menjëherë pas lindjes.

b) Prej 6 muajsh, foshnjat duhet t'u ofrohen ushqime të ngurta të dendura në vlera ushqyese dhe jo kalori. Alergjenët potencial duhet të testohen bashkë me ushqimet e tjera. Foshnjat dhe fëmijët duhet të konsumojnë llojllojshmëri ushqimesh nga të gjitha grupet ushqimore. T'i jepet prioritet ushqimeve të pasura me hekur dhe zink, sidomos për foshnjat që ushqehen me qumësht gjiri.

c) Nga mosha 12 mujore, duhet të respektohet një mënyrë e shëndetshme e të ushqyerit gjatë

tërë jetës, në mënyrë që të përmbushen nevojat nutricionalë, të arrihet një peshë e shëndetshme trupore dhe të reduktohet rreziku për sëmundje kronike.

2. Të shijohen ushqimet dhe pijet e pasura me vlera ushqyese, duke konsideruar preferencat personale, traditat kulturore dhe buxhetin.

Një mënyrë e shëndetshme e të ushqyerit mund t'i ndihmojë të gjithë njerëzit, pavarësisht moshës, racës, përkatësisë etnike apo statusit shëndetësor.

3. Të ketë fokus në marrjen e të gjitha grupeve ushqimore me vlera ushqyese, duke qëndruar brenda limiteve të kalorisë.

Ushqimet e dendura me vlera ushqyese ofrojnë vitamina, minerale dhe komponentë të tjerë ushqimorë që promovojnë shëndetin, por kanë sasi të ulëta të sheqerit, yndyrës së ngopur dhe natriumit. Elementet bazë që përbëjnë një model të shëndetshëm të ushqimit janë:

- Të gjitha llojet e perimeve - të gjelbërta, të kuqe, portokallta.
- Frutat - sidomos frutat e plota.
- Drithërat - të paktën gjysma e të cilave duhet të jenë drithëra të plota (integrale).
- Produktet e qumështit.
- Ushqimet e pasura me proteina.
- Yndyrat.

4. Të limitohen ushqimet dhe pijet e pasura me sheqer të shtuar, yndyrë të ngopur dhe natrium.

Në çdo fazë jetësore, konsumimi i ushqimeve nga të gjitha grupet ushqimore duhet të bëhet bashkë me limitimin e kalorive dhe natriumit. Një mënyrë e shëndetshme e të ushqyerit nuk ka shumë vend për sheqer të shtuar, yndyrë të ngopur apo natrium. Limitet janë:



- a) Për sheqer të shtuar - më pak se 10% të kalorive, duke filluar nga mosha 2 vjeçare. Të evitohet konsumimi i ushqimeve dhe pijeve me sheqer të shtuar deri në moshën 2 vjeçare.
- b) Për yndyrë të ngopur - më pak se 10% të kalorive, duke filluar nga mosha 2 vjeçare.
- c) Për natrium - më pak se 1000mg në ditë për fëmijët e moshës 1-3 vjeç, më pak se 1200mg në ditë për fëmijët e moshës 4-8 vjeç.

Grupet ushqimore

Ekzistojnë 5 grupe ushqimore bazë të cilat fëmijët duhet t'i konsumojnë në baza ditore apo javore. Këtu hyjnë:
Perimet - mund të përdoren të freskëta, të pjekura apo të ziera. Gjatë sezonës, preferohet përdorimi i perimeve të freskëta, ndërkaq jashtë sezonës mund të përdoren edhe ato të ngrira apo konservuara.

Spinaqi, brokoli, lulëlakra, kungulleshka, patëllxhani i zi, qepa, hudhra, sallata e gjelbër, trangulli, karota, rrepa e kuqe, domatet, rrepa e kuqe, speci, lakra e bardhë dhe e kuqe, boranijat.

Frutat - mund të përdoren të freskëta, të pjekura, të thata apo si lëng i shtrydhur. Të përdoren sipas sezonës.

Molla, dardha, banania, portokalli, mandarinat, kivi, dredhëzat, pjeshka, pjepri, shalqiri, kajsitë, rrushi i tharë, kumbullat e thata.

Drithërat dhe perimet me amidon

Buka, orizi, makaronat, bollguri, kuinoa, kuskusi, mielli i misrit, tërshëra, drithërat e mëngjesit, patatet e bardha, patatja e ëmbël, bizelet, misri.

Mishi dhe nënproduktet e mishit

Mishi i viçit, pulës, peshkut, veza, fasulet, thjerrëzat, qiçrrat dhe arrat.

Produktet e qumështit

Qumështi, kosi, jogurti, djathi.

Yndyrat

Vaji i ullirit, luledielli, gjalpi, ullinjte, arrat, bademet, lajthitë, farat e lirit, luledielli, kungullit, avokado.

Modeli i shujtave

Një nga qëllimet kryesore të krijimit të menisë për kopshte është servimi i shujtave dhe zamrave të pasura me vlera ushqyese, të cilat përputhen me modelin e krijuar të shujtave dhe të cilat u pëlqejnë fëmijëve. Në mënyrë që kjo të arrihet, kuzhina qendrore duhet të sigurohet që çdo shujtë që u servohet fëmijëve të përmbajë të gjithë komponentët ushqimorë, në sasinë e përcaktuar për grupmoshat e ndryshme si më poshtë:

Mëngjesi:

Mëngjesi duhet të jetë i pasur me proteina, fibra, kalcium, vitaminë C dhe sasi të moderuar të yndyrës së shëndetshme. Prandaj, sipas këtij modeli, mëngjesi duhet të përmbajë të paktën:

- 1 porcion proteina (qumësht, kos, djathë, vezë)
- 1 porcion drithëra (bukë, tërshërë, drithëra të mëngjesit, miell misri, grizë)
- 1 porcion frut ose perime (çfarëdo fruti apo perime i plotë, ose lëng i shtrydhur i frutave apo perimeve)

Dreka:

Dreka që u ofrohet fëmijëve duhet të përmbajë të paktën:

- 2 porcione perime (2 ose më shumë lloje të perimeve)
- 1 porcion drithëra apo ushqime tjera të pasura me amidon (oriz i kaftë, bollgur, patate, bizele, bukë, makarona)
- 1 porcion ushqime të pasura me proteina (mish viçi, mish pule, peshk, fasule, thjerrëza, bizele apo kos)
- 1 porcion yndyrë për përgatitje (vaj ulliri, luledielli apo gjalpë)

Zamra:

Qëllimi i zamrës është të jetë e shëndetshme, e pasur me proteina dhe fibra, kurse e ulët në sheqer dhe yndyrë. Prandaj, zamra duhet të përmbajë të paktën 2 nga 3 komponentët:

- 1 porcion fruta të plota
- 1 porcion produkte të qumështit (qumësht, kos apo djathë)
- 1 porcion drithëra (bukë, tërshërë, oriz, drithëra të mëngjesit)



Frutat:

- Të ofrohet të paktën 1 porcion i frutave për fëmijë çdo ditë.
- Të ofrohet llojllojshmëri e frutave (të paktën 2 lloje gjatë ditës) dhe të paktën 4 lloje gjatë javës.
- Të ofrohen frutat e thata deri 1 herë në javë.
- Të ofrohen lëngjet e frutave dhe perimeve të shtrydhura 100% prej frutit, pa sheqer të shtuar.

- Të ofrohen burimet e mira të vitaminës A (pjeshka, shalqiri, kajsia, portokalli dhe mandarinat) të paktën 2 herë në javë.
- Të ofrohen burimet e mira të vitaminës C (molla, banania, dredhëzat, portokalli, mandarina, kumbulla, pjeshka, shalqiri, pjepri) çdo ditë.

Perimet:

- Të ofrohen të paktën 1 porcion e gjysmë perime në ditë.
- Të ofrohet llojllojshmëri e perimeve (të paktën 2 lloje gjatë ditës) dhe të paktën 4 lloje gjatë javës.
- Të ofrohen burimet e mira të vitaminës A (sallata e gjelbër, spinaqi, karrota, brokoli, bizelet, patatja e ëmbël, domatja) të paktën 2 herë në javë.
- Të ofrohen burimet e mira të vitaminës C (brokoli, lakra, lulëlakra, domatja, speci, boranijat, bizelet) çdo ditë.

Drithërat:

- Të ofrohen të paktën 2 porcione të drithërave për fëmijë çdo ditë.
- Të ofrohen drithëra me sasi të lartë të fibrave (tërshëra, bollguri, mielli i misrit, orizi

- integral) të paktën 3 herë në javë, preferueshëm çdo ditë.
- Të ofrohen drithëra të mëngjesit të cilat nuk përmbajnë më shumë se 10 gramë sheqer për porcion (e deklaruar në etiketë ushqimore).

Produktet e qumështit:

- Të ofrohen të paktën 2 porcione të produkteve të qumështit në ditë.
- Të ofrohen qumështi dhe kosi me 3,5%.
- Të limitohet konsumimi i ajkës dhe gjalpë.

Mishrat dhe alternativat:

- Të ofrohet të paktën 1 porcion i mishit, vezëve, fasuleve apo thjerrëzave në ditë.
- Të ofrohet mishi i kuq pa yndyrë deri 2 herë në javë.
- Të ofrohet mishi i pulës deri 2 herë në javë.
- Të ofrohen fasulet, thjerrëzat apo bizelet të paktën 1 herë në javë.
- Të ofrohet peshku të paktën 1 herë në muaj.

Yndyrorët e shëndetshme:

- Të përdoren vajrat e monosaturuara apo polisa-

Nevojat ushqyese

Tabela më poshtë tregon nevojat e vlerave ushqyese të fëmijëve të grup moshave të ndryshme, duke marrë për bazë Referencat Dietetika (DRIs) nga Instituti i Medicinës (IOM).

Vlerat ushqyese	Mosha 1 - 2 vjeç	Mosha 3 - 6 vjeç
Kaloritë(kcal/ditë)	800-1000	1200-1600
Karbohidratet(g/ditë)	130	130
Proteina(g/ditë)	13	19
Fibra(g/ditë)	14	17
Kalcium(mg/ditë)	700	1000
Hekur(mg/ditë)	7	10
Vitaminë A(mcg/ditë)	300	400
Vitaminë C(mg/ditë)	15	25
Natrium(mg/ditë)	1000	1200

KU'ZINA

POROSIT USHQIM

Për porosi mbi 10 Euro
TRANSPORTI FALAS

0800 08888

Kuzhina Qendrore Sh.A

kuzhinaqendrore

kuzhina.net



turuara gjatë përgatitjes, si vaji i ullirit apo lulediellit.

- Të përdoret gjalpi jo më shumë se 2 herë gjatë javës në gatime.
- Të limitohet sasia e vajit apo yndyrëve në jo më shumë se 15g (3 lugë të vogla) në ditë.

Ushqimet me sheqer, kripë dhe yndyrë të shtuar:

- Të limitohet përdorimi i ushqimeve të gatshme si



biskota, ëmbëlsira, pudingë të gatshëm, jogurta të frutave të gatshme, lëngjeve të frutave të gatshme.

Uji:

- Të ofrohet uji në shumicën e rasteve gjatë shujtave, dhe gjatë ditës
- Të mos tejkalohe sasia e rekomanduar e sheqerit gjatë përgatitjes së çajit.

Përdorimi i mëlmesave

- Të limitohet sasia e kripës gjatë përgatitjes në jo më shumë se 1g në ditë.
- Të përdoren mëlmesat dhe erëzat gjatë përgatitjes: hudhra, rozmarina, dafina, origano, menta.

**TEKST I SPONSORIZUAR
NGA KU'ZINA**



Bujar Terstena (RFE/RL)

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kurti dhe Rama nënshkruajnë marrëveshjen për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti dhe kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, në emër të qeverive respektive, nënshkruan të premtën Marrëveshje të Bashkë-

punimit për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Qeveria e Kosovës ka njoftuar se me këtë marrëveshje mundësohet organizimi i sportit të lundrimit në Durrës të Republikës së Shqipërisë dhe, njëherësh, zyrtarizon

Durrësin si një nga qytetet mikpritëse të këtyre lojërave. "Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030 do të jenë ngjarja më e madhe sportive në histori të vendit, që përmes investimeve do të kontribuojë drejtpërdrejt në

përmirësimin dhe avancimin e infrastrukturës sportive, kurse përmes mikpritjes në përfaqësimin dhe promovimin ndërkombëtar të republikës sonë", thuhet në njoftimin e Kryeministrit të Kosovës.



Llapi harron çka është fitorja, sot zhvillohen dy ndeshje në Superligë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Skuadra e Llapit ka harruar se si të fitohet, pasi edhe në ndeshjen e njëmbëdhjetë radhazi nuk ka arritur t'i marrë tri pikët e plota. Në fakt, Llapi ka luajtur në stadiumin "Zahir Pajaziti" bars me Dukagjinin (0-0) në ndeshjen e javës së 18 në Superligë. Pjesa e parë e ndeshjes u karakterizua me lojë më të mirë të vendësve por, përkundër rasteve të krijuara, portat mbeten të paprekura dhe ekipet shkuan në pushim me rezultatin 0-0. Në pjesën e dytë vendasit krijuan më shumë raste, por nuk arritën t'i konkretizojnë, ashtu sikurse edhe mysafirët.

Llapi shënoi një gol në minutat shtesë me Hamdi Namanin, por goli u anulua nga VAR-i dhe ndeshja përfundoi 0-0. Llapi e mbyll sezonin në pozitën e tetë me 17 pikë, ndërsa Dukagjini zë pozitën e shtatë me 21 pikë. Dy ndeshje të tjera të xhiros së fundit për sezonin vjeshtor zhvillohen sot (e shtunën) dhe dy të tjera nesër (e diel). Sot do të jetë një ndeshje derbi në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet ku Prishtina e pret skuadrën në formë të mirë, Malishevën. Të këto dy klube do të përpiqen ta marrin maksimumin e pikëve në këtë ndeshje. Po të njëjtën ditë përballen edhe Ferizaj dhe Gjilani. Gjilani me fitoren e fundit në xhiron e kaluar ndaj



Dritës ka rikthyer besimin për rezultate pozitive, kurse Ferizaj është në vendin e parafundit dhe ka vetëm 17 pikë. Një tjetër ndeshje derbi zhvillohet të dielën mes dy

skuadrave nga qyteti i Suharekës, Suharekës dhe Ballkanit. Kampionët janë në vendin e dytë me 30 pikë, kurse Suhareka është në vendin e pestë me një

SUPERLIGA - Java 13

Të shtunën takohen:
17:00 Sigal Prishtina - Bashkimi
19:00 Peja - Trepça

Të dielën takohen:
17:00 Bora - Proton Cable Prizreni
19:00 Golden Eagle Ylli - Vëllaznimi

diferencë prej pesë pikësh. Ndeshja tjetër është në mes të Feronikelit '74 dhe Dritës. "Nikli" në tri ndeshjet e fundit ka regjistruar rezultate pozitive dhe këtë do të përpiqet ta bëjë edhe ndaj lideres aktuale, Dritës. Gjilanasit në anën tjetër presin t'u rikthehen fitoreve pas humbjes në xhiron e kaluar.

Sot dy ndeshje në elitën e basketbollit

PRISHTINË, 20 SHTATOR - Fundjava do të sjellë super derbi në javën e 13-të të ProCredit Superligës, apo njëkohësisht e parafundit për vitin 2024. Xhiroja do të hapet me ndeshjen e skuadrave me traditë në vendin tonë, Sigal Prishtinës dhe Bashkimit. "Bardhekaltrit" kanë gjashtë fitore e pesë humbje, ndërsa "Portokallezintë" tetë fitore e katër humbje, andaj pritet një takim shumë interesant. E shtuna do të vazhdojë me derbin tjetër në mes të Pejës dhe Trepçës, po ashtu dy

skuadra me traditë në basketbollin e Kosovës. "Verdhezinjtë" ndodhen në vendin e katërt me gjashtë fitore e gjashtë humbje, ndërsa kampionët në vendin e parë me dhjetë fitore e dy humbje. Përballja pritet të jetë mjaft interesante në "Karagaçi". Të dielën do të përballen Bora me Proton Cable Prizrenin, në një sfidë mjaft të rëndësishme për të dy skuadrat. Prishtinasit janë në vendin e tetë me dy fitore e nëntë humbje, kurse prizrenasit në vendin e shtatë



me tri fitore e nëntë humbje. Kjo xhiro do të mbyllet me ndeshjen ndërmjet Golden

Eagle Yllit dhe Vëllaznimit. Therandasit janë në vendin e tretë me shtatë fitore e pesë

SUPERLIGA - Java e 18

Llapi - Dukagjini 0-0

Të shtunën takohen:
Ferizaj - Gjilani
Prishtina - Malisheva

Të dielën takohen:
Suhareka - Ballkani
Drita - Feronikeli '74

humbje, ndërsa kuqezinjtë kanë pesë fitore e shtatë humbje, duke u pozicionuar në vendin e gjashtë.

Rahoveci dimëron në vendin e parë

Rahovec, 20 dhjetor - Me tri ndeshje të zhvilluara ka përfunduar stinori vjeshtor në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Skuadrat favorite nuk kanë lejuar befasi. Kampioni dhe lideri i klasifikimit, Rahoveci, fitoi 43:33 ndaj Llapit në Podujevë. Arbios Mushkolaj i

kishte 11 gola, ndërsa Mali Luzha dhjetë të "vreshtarët". Nga dhjetë gola për Llapin i realizuan Blerton Hasani e Ardi Halili. Besa Famgas fitoi në udhëtim ndaj Vushtrrisë me rezultat 50:29. Edonis Hajra i kishte 11 gola tek ekipi pejan, ndërsa nga tetë i realizuan Olsi Mulaj e Jon Vokshi. Tetë gola për

Vushtrrinë i kishte Egzon Ademi e shtatë Muhamet Hyseni. Në Mitrovicë, Kastrioti fitoi ndaj Trepçës me rezultat 46:37. Yassine Henahen i kishte 11 gola për ferizajasit, derisa Gëntrit Brahimi e Besnik Bytyqi i realizuan nga gjashtë. Amar Mujka i shënoi 16 gola për "xehetarët", ndërsa 11 i

kishte Ermir Smaka. Rahoveci e ka përfunduar stinorin vjeshtor me 28 pikë. I ka fituar të gjitha 14 ndeshjet dhe dimëron në pozitën e parë. Besa Famgas e Kastrioti i kanë nga 22. Pason Prishtina në vendin e katërt me 16 pikë. Vushtrria, Vjosa e Llapi i kanë nga tetë pikë në pozitë pesë, gjashtë



e shtatë. Trepça mbetet e fundit, pa pikë.

Verstappen: S'më intereson krahasimi me Hamiltonin apo Schumacherin, dua të argëtohem dhe fitoj

HASSELT, 20 DHJETOR - Titulli i fituar këtë vit, i katërti në karrierën e tij, e vendosi Max Verstappen në elitën absolute të Formulës 1 edhe nga pikëpamja statistikore. Holandezi i Red Bullit, në moshën vetëm 27-vjeçare, është piloti i tretë më i suksesshëm në historinë e

sportit dhe barazohet në vendin e katërt për nga numri i titujve të fituar. Ndaj është e pamundur të mos e përfshish atë në debatin klasik për të përcaktuar se cili është piloti më i madh i të gjitha kohëve, me Lewis Hamiltonin e Michael Schumacherin që kanë nga shtatë tituj

kampionë bote. Megjithatë, Verstappen nuk ka treguar kurrë interes të veçantë për këtë lloj diskutimi. Gjatë një interviste të dhënë për mediet, ai shpjegoi qartë se nuk mendonte për trashëgiminë e tij në historinë e Formulës 1, por është fokusuar vetëm në arritjen e

rezultateve më të mira të mundshme. "Kush është më i madh? Nuk më intereson, të jem i sinqertë. Jam shumë i kënaqur me atë që po bëj. Ky është një debat me shumë mendime të ndryshme, kështu që për mua nuk ka rëndësi. Unë dua vetëm të argëtohem dhe të fitoj sa më



shumë që të jetë e mundur", ka thënë Verstappen.

Di Maria: Messi ishte fati i jetës time

LISBONË, 20 DHJETOR - Angel Di Maria ka folur për mirënjohjen e tij ndaj Lionel Messit, duke shprehur falënderimet e tij të përzemërta pasi numri "10" që bëri kalimin te Paris Saint-Germaini (PSG) nga Barcelona në vitin 2021. Anëtori i Benficës theksoi dëshirën e tij për të pasur më shumë momente përkrah lojtarit ikonik, duke uruar për ta ndarë dhomën e zhveshjes me të në nivel klubi. Në një bisedë tërheqëse me "DSports Radio", Di Maria tregoi lidhjen e fortë që ndan me Messin, duke zbuluar se ai e inkurajoi sulmuesin e Inter Miami të bashkohej me PSG-në kur Messi ishte një futbollist i lirë. "Të luaja me Messin ishte kulmi i karrierës sime. Është vërtet përvoja më e mirë, dhe pas gjithë këtyre viteve, të krijosh një miqësi... ai është fenomenal si brenda dhe jashtë fushës. E pata atë shans dhe pas ndeshjes sime të fundit në fushë të PSG-ja, i thashë: 'faleminderit që më lejove ta përjetoj gjithë këtë me ty'. Kur ai u largua nga Barcelona, Paredes dhe unë i kërkua atij që të bashkohej



me ne, ndërsa nuk ndodhi që unë të shkoja në Barcelonë, gjithçka që dëshiroja ishte t'i ndaja ato momente me të çdo ditë. Ishte diçka e veçantë për mua", thotë argjentinasin. Thashethemet po qarkullojnë për një ribashkim të mundshëm mes Angel Di Maria dhe Lionel Messi, me Inter Miami që raportohet se është i interesuar për nënshkrimin e tij. Kontrata e Di Marias me Benficën do të zgjasë deri në verën e vitit 2025. Duke u thelluar më thellë në mendimet e tij për Messin në krahasim me Cristiano Ronaldo, Di Maria ka përjetuar në mënyrë unike të luajë me të dy legjendat. Në një sferë ku shumë largohen nga zgjedhja e një skuadre, argjentinasin e ka shpallur vazhdimisht Messin si lojtar superior. Gjatë një bisede me

gazetarin Juan Pablo Varsky në Clank! Në fillim të këtij viti, Di Maria deklaroi: "Unë kam mbajtur vazhdimisht të njëjtën perspektivë, ata janë dy më të mirët në histori. Megjithatë, është e qartë se Leo dallohet me një diferencë të konsiderueshme. Koleksioni i tij prej tetë çmimeve të 'Topit të Artë' flet shumë, por ka të bëjë më shumë se thjesht se Cristiano ka të bëjë me punën e palodhur përpjekje për të qenë më të mirët". Ai vazhdoi, duke thënë: "Cristiano i është përkushtuar orëve stërvitje intensive, duke përsosur aftësitë e tij të finalizimit, duke i shtyrë vazhdimisht kufijtë e tij. Por Leo luan sikur po shijon një lojë futbollit me miqtë e tij, tepër thjeshtë dhe pa u sforcuar. Kjo është ajo që i dallon ata". Në total, Angel Di Maria ka luajtur së bashku me Lionel Messin në 141 raste, si në nivel klubesh ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, duke kontribuar në 16 gola të përbashkët. Ndërkohë, ai ka ndarë fushën me Cristiano Ronaldo te Real Madrid në 166 raste, duke rezultuar në 28 gola të përbashkëta.

SHKURT

Asllani pas golit nga korneri: Nuk më kishte ndodhur kurrë

Kristjan Asllani shënoi një gol nga këndorja për Arsenalin në fitoren ndaj Udineses në Kupën e Italisë. Mesfushori shqiptar shkëlqeu me paraqitje të mirë, e cila u vulos edhe me gol. E pas ndeshjes, ai ka thënë se nuk i kishte ndodhur asnjëherë. "Nuk më kishte ndodhur kurrë të shënoja gol direkt nga këndi. Megjithatë sonte e rëndësishme ishte fitorja dhe jemi të lumtur sepse po u japim vazhdimësi rezultateve", ka thënë fillimisht Asllani për faqen zyrtare të klubit. "Grupi ynë është fantastik, ka një kimi të madhe mes nesh në dhomat e zhveshjes, ne dalim shpesh bashkë dhe kjo, gjithashtu, çon në rezultate. Më duhet ta falënderoj edhe Arnautoviqin për mbështetjen e tij, sepse ai është një nga ata që gjithmonë ndihmon më të rinjtë dhe është thelbësor për të gjithë ne", ka përfunduar mesfushori shqiptar.

Zidane kërkon katër transferime për t'u rikthyer si trajner i Realit

Zinedine Zidane mund të kthehet në drejtimin e Real Madridit, por vetëm nëse plotësohen disa kushte. Raportet nga Real Madrid Confidential zbulojnë se Zidane ka bërë kërkesa specifike që klubi të nënshkruajë me katër lojtarë kyç përpara se të pranojë ta marrë sërish drejtimin e ekipit. Strategu francez ka kërkuar nënshkrimin e menjëhershëm të Alphonso Davies, Joshua Kimmich, Jonathan Tah dhe Florian Wirtz. Këta lojtarë shihen si jetikë për vizionin e tij për forcimin e skuadrës dhe sigurimin e suksesit në të ardhmen. Ndërsa Xabi Alonso konsiderohet një kandidat i fortë për këtë rol, emri i Zidanes mbetet në përzierje për shkak të kushteve të tij të mëparshme me klubin. Megjithatë, sjellja e të katër lojtarëve mund të jetë sfiduese, duke kërkuar planifikim dhe investim të kujdesshëm nga Real Madrid. Vendimi përfundimtar për rikthimin e Zidanes do të merret nga bordi i klubit. Ata do t'i peshojnë përfitimet nga riemërimi i francezit kundrejt sfidave të mundshme të sigurimit të këtyre nënshkrimeve të profilit të lartë.

Dominimi kudo, Slot: Normale për një ekip si Liverpooli

Trajneri i Liverpoolit, Arne Slot, në prag të ndeshjes së radhës në Premierë Ligë, atë ndaj Tottenhamit, ka folur për paraqitjet e deritanishme të skuadrës së tij. Ai komenton se nuk është aspak i befusuar që skuadra e tij po konkurren me sukses në të gjitha turnetë. "Kjo është normale për një ekip si Liverpooli. Të luftosh për çdo trofe është pjesë e historisë së këtij klubi. Për ne është e rëndësishme të shkojmë deri në fund të çdo turneu ku marrim pjesë", ka thënë Slot. "Nuk jam aspak i befusuar që po garojmë për katër trofe, por është një sfidë sepse kemi shumë konkurrencë me ekipet e tjera. Ne jemi kampionë në fuqi në Carabao Cup dhe duam ta mbrojmë këtë titull, njëkohësisht duam të fitojmë kudo", ka shtuar Slot. Skuadra e tij kryeson renditjen në Premierë Ligë, por komandon edhe në Ligën e Kampionëve.

Bostoni 'dorëzohet' në shtëpi, fitojnë lakersat dhe Oklahoma

BOSTON, 20 DHJETOR - Kampionët e Bostonit u mundën me rezultat 117-108 në fushën e tyre nga Chicago, duke humbur ndjeshëm terren në renditje. Zach LaVine me 36 pikë ishte shënuesi më i mirë për Bulls-in, duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e Tatumit për vendasit. Humbet edhe ekipi i Golden States, që u mund me rezultat 144-93 nga Memphis. Vendimtar stoli i ekipit vendës, nga erdhën 81 pikë. Pas kohës shtesë fitoi San Antonio, që mundi me rezultat 133-126 Atlantian, sfidë ku u dallua Wembanyama, autor i 42 pikëve. Jashtë fushës fitoi edhe skuadra e lakersave, që mundi me



rezultat 113-100 Sacramenton. Ndeshje e mirë për Reaves, që realizoi 25 pikë, mbështetur nga Davisi me 21 pikë e 19 rebounde. Në këtë ndeshje LeBron Jamesi vendosi rekordin e minutave të luajtura në kohën e rregullt në NBA, me 57.471 minuta. Ai kaloi një legjendë si Kareem Abdul Jabbar.

REZULTATET

Detroit - Utah Jazz	119-126
Orlando - Oklahoma	99-105
Washington - Charlotte	123-114
Boston - Chicago	108-117
Toronto - Brooklyn	94-101
Houston - New Orleans	133-113
Memphis - Golden State	144-93
San Antonio - Atlanta	133-126
Dallas - Clippers	95-118
Phoenix - Indiana	111-120
Minnesota - New York	107-133
Portland - Denver	126-124
Sacramento - Lakers	100-113

Haaland: Besojmë te ringritja dhe Guardiola

Erling Haaland, një nga yjet e Manchester Cityt, u shpreh se ai dhe të gjithë lojtarët vazhdojnë të besojnë në "procesin" dhe drejtimin e Pep Guardiolas, pavarësisht prej rezultateve të kohëve të fundit. Shanset për të siguruar

një titull të pestë radhazi në Premierë Ligë duken të vakëta duke parë shkëputjen e rivalëve. "Citizens" vjen nga humbja zhgënjyese në derbi ndaj Manchester Unitedit, disfatë që erdhi në pesë minutat e fundit të ndeshjes.

"Ne nuk jemi ende afër nivelit tonë, por unë ende besoj se po luajmë mjaft mirë për të marrë pikë dhe rezultate", ka thënë sulmuesi norvegjez. "Mendoj se gjithçka ka të bëjë me të qëndruarit të fokusuar gjatë gjithë 90 minutave.

Thjesht duhet të përqendrohemi siç duhet. Duhet të qëndrojmë së bashku, të rigrupohemi dhe të besojmë në veten tonë pas asaj që kemi arritur në të kaluarën", ka shtuar Haalandi. Në fund, edhe një koment për

trajnerin Pep Guardiola: "Ne vazhdojmë të besojmë në procesin e ringritjes së klubit dhe te trajneri ynë. Jam i sigurt se nëse e bëjmë këtë, do të kthehemi në mënyrat e fitoreve dhe do të kthehemi në nivelin tonë".



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Princi Company” Sh.p.k Harilaq, Fushë Kosovë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e seleksionimit dhe ambalazhimit të plastikes, letrës, qelqit, metaleve si dhe djegien e mbeturinave medicinale-barnave me afat te skaduar (shtimi i kodeve te reja) në Harilaq, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.02.2025 në ora 10:00 në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët “Bajram Curri”, fshati Sllatinë e Madhe, komuna Fushë Kosovë do të organizohet debat publik nga Kompania “Princi Company” Sh.p.k Harilaq, Fushë Kosovë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debat i Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68piZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Princi Company” Sh.p.k Harilaq, Fushë Kosovë për fabrikën e seleksionimit dhe ambalazhimit të plastikes, letrës, qelqit, metaleve si dhe djegien e mbeturinave medicinale-barnave me afat te skaduar (shtimi i kodeve te reja) në Harilaq, Fushë Kosovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnj.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Labinot Haziri nga Prishtina shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e Gjimnazit “Eqrem Çabej” Prishtinë.

Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

Ardian Bozhegu nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Ardian Pozhegu” B.I. Me nrb: 810244012.

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Blenda Gashi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](https://www.instagram.com/lumesdetails)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

